



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1712/1 prot.

Tiranë më 13. 11.2019

Lënda: Përgjigje kërkesës për mendim

FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u njoh me kërkesën tuaj, administruar me nr. 1712 prot, datë 30.10.2019, dhe me rrethanat e parashtruara nga ana juaj. Paraprakisht, vlerësojmë angazhimin tuaj në respekt të detyrimeve ligjore dhe në këtë kuadër, ju bëjmë me dije lidhur me disa detyrime që kenë në cilësinë e kontrolluesit, në kuadër të respektimit të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, duhet kryer duke pasur parasysh respektimin e nenit 5/b, të Ligjit nr. 9887 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, mbrojtja e të dhënave personale, bazohet: *b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime:...*

Zyra e Komisionerit vlerëson se, aksesi në të dhënat personale dhe sensitive konsiderohet përpunim dhe përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Të dhënat personale përpunohen vetëm: *ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit:...*

Nga shqyrtimi i kërkesës tuaj dhe konsultimi i VKM nr. 330, datë 28.05.2014 “Për miratimin e udhërrëfyesit për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian, 2013“, rezulton se udhërrëfyesi përcakton hapat që do të ndiqen me qëllim realizimin e prioritetëve të rekomanduara nga Komisioni Evropian por nuk legjitimon aksesin e Prokurorisë në sistemin elektronik të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sipas parashikimit ligjor të sipër cituar.

Në këtë rast, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga udhërrëfyese për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian duhet hartuar/miraturar një parashikim ligjor konkret me qëllim që aksesit në sistemin elektronik të FSDKSH-së të konsiderohet i ligjshëm.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi
Besnik Dervishi

